



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 115
Prishtinë, më 25 prill 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 25 PRILL 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryesuesi i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Teuta Sahatqija, Shaip Muja, Teuta Haxhiu, Afrim Hoti, Halit Krasniqi, Salih Morina, Alma Lama, Emilija Rexhepi, Nijazi Idrizi, Sabri Hamiti, Kymete Bytyçi, Hamza Balje, ministri Fehmi Mujota, Ali Sadriu, Ismet Beqiri dhe Valbona Dibra, diskutimet e të cilave janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Teuta Haxhiu parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë pse nuk është përkrahur financiarisht nga Qeveria e Kosovës ngritja e kompleksit memorial në Meje dhe kur do të fillojë përmeshja e premtimeve të dhëna qeverisë komunale dhe familjarëve të të zhdukurve.

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtoi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë pse ministria që ai drejton ka qenë pasive dhe cili është qëndrimi i Ministrisë së Drejtësisë lidhur me të drejtën e përfaqësimit të AKP-së, veçanërisht në çështjen e dy ndërmarrjeve shoqërore, “Apiko” dhe “Iliria”, duke ia falur, siç tha ajo, ngastrat e këtyre ndërmarrjeve Manastirit të Deçanit.

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me hapat që ka ndërmarrë ministria që ai drejton për ndërtimin e një qendre të rehabilitimit për veteranët dhe ushtarët e UÇK-së.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mëparshme

Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 11 dhe 18 prill 2013, pa asnjë vërejtje.

* * *

Në vazhdim, në lidhje me rendin e ditës së punimeve të mbledhjes së sotme plenare pati dy propozime:

1. Deputetja Teuta Sahatqija propozoi që pika - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregun dhe produktet e naftës në Kosovë të hiqet nga rendi i ditës dhe i njëjti t’i kthehet Qeverisë me arsyetim se nene të caktuara janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin deputetëve lidhur me propozimin e deputetes Teutë Sahatqija.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi propozimin që Projektligji për tregun dhe produktet e naftës në Kosovë të shtyhet për mbledhjen plenare të radhës.

2. Deputetja Duda Balje, në emër të GP “6+”, propozoi që pika - Miratimi i marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë dhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete të shtyhet për mbledhjen plenare të radhës.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin deputetëve lidhur me propozimin e deputetes Duda Balje.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi propozimin deputetes Duda Balje që miratimi i marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë dhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete të shtyhet për mbledhjen plenare të radhës.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

4. Interpelanca e ministrit të Shëndetësisë, z. Ferid Agani, sipas kërkesë së deputetes Time Kadrijaj, mbështetur edhe nga 9 deputetë tjerë, lidhur me gjendjen në shëndetësinë e Kosovës

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për administrimin e punës në zyrë,

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës,

7. Zgjedhja e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore,

4. Interpelanca e ministrit të Shëndetësisë, z. Ferid Agani, sipas kërkesë së deputetes Time Kadrijaj, mbështetur edhe nga 9 deputetë tjerë, lidhur me gjendjen në shëndetësinë e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se deputetja Time Kadrijaj, mbështetur edhe nga 9 deputetë tjerë, ka parashtruar kërkesë për interpelancë me ministrin Ferid Agani lidhur me gjendjen në shëndetësinë e Kosovës.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputetja **Time Kadrijaj**, në emër të grupit të deputetëve nënshkrues, tha se gjendja e rëndë e sistemit të shëndetësisë në Kosovë është e papranueshme si pasojë e keqmenaxhimit, që fillon në krye të qeverisjes së vendit dhe në gjithë zinxhirin e saj menaxhues.

Që nga marrja e mandatit si ministër i Shëndetësisë, ministri Ferid Agani u zotua se do ta reformojë sistemin e shëndetësisë, duke ndërtuar mekanizma të kontrollit, fillimisht nëpërmjet ndryshimit të Ligjit për shëndetësi, miratimit të Ligjit për sigurime shëndetësore, si dhe plotësim-ndryshimit të legjislacionit të brendshëm për mbarëvajtjen e punës së kësaj ministrie dhe institucioneve në varësi të saj.

Gjatë mandatit të tij e kanë karakterizuar një sërë aferash, të cilat e dëmtojnë rëndë Buxhetin e Kosovës, por edhe e ulin imazhin e shëndetësisë, në përgjithësi.

Në vazhdim, ajo tha se sistemi i shëndetësisë, edhe sipas vetë ministrit, është totalisht i korruptuar dhe i centralizuar, ndërsa konstatoi se asnjë masë në këtë drejtim nuk është ndërmarrë nga Ministria e Shëndetësisë.

Më tej, deputetja Time Kadrijaj e kritikoi refuzimin e zbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për rihapjen e konkursit për drejtorë të klinikave dhe shërbimeve në Qendrën Klinike Universitare, i cili vendim as sot e kësaj dite nuk po zbatohet.

Qendra Klinike Universitare e Kosovës punon me ushtrues detyre të klinikave dhe shërbimeve që nga viti 2010. Këtu i kam kopjet dhe vendimet e Gjykatës Supreme, por edhe të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe ministri në fakt këto vendime i ka zbatuar në mënyrë parciale, e jo tërësisht.

Pastaj, ajo e përmendi edhe rastin e zyrtarëve të lartë në Ministrinë e Shëndetësisë, të cilët njëkohësisht janë edhe specializantë. Përsëri Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka marrë vendim që këta në mënyrë joligjore gjenden në vendet e tyre të punës.

Më tej, ajo u fokusua, siç tha, në disa skandale në Ministrinë e Shëndetësisë, duke përmendur skandalin me citostatikë, skandali me insulina, rastet kur në barnatoret private po gjenden në

shitje insulinat që janë nga lista esenciale, rasti i penjve kirurgjikë dhe mospajisja e spitaleve dhe e Qendrës Klinike Universitare me barna nga lista esenciale.

Problemet brenda Inspektoratit Shëndetësor dhe animi juaj nga njëra palë, veç sa e dëmton imazhin tuaj dhe të Ministrisë së Shëndetësisë.

Mosfunksionalizimi i Spitalit të Mitrovicës dhe pamundësia e delegimit të mjekëve në këtë spital, përsëri është një dështim.

Kjo Qeveri po pretendon ta reformojë sistemin shëndetësor në tërësi, kurse për 5 vjet nuk ka arritur ta rregullojë asnjë spital dhe as Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, theksoi ajo.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Shëndetësisë ta marrë fjalën.

Ministri **Ferid Agani** tha se nëse duhet ta përmbledhim me një fjali situatën aktuale në Shëndetësi, atëherë do të vlerësoja se gjendja në shëndetësinë kosovare cilësohet me vështirësi të shumta, por njëkohësisht është shumë më e mirë se para dy vjetëve, veçanërisht në aspektin e perspektivave për ta arritur një sistem evropian të shërbimeve shëndetësore.

Gjendja në shëndetësi në masën më të madhe është rezultat i sistemit anakronik të centralizuar dhe të politizuar shëndetësor, e si i tillë me kohë u korrptua në masë të madhe, veçanërisht në sektorin farmaceutik, si dhe në sektorin e punësimit të njëkohshëm, në sektorin publik dhe privat. Dhe, njëkohësisht administrata tejet fragjile shtetërore në Ministrinë e Shëndetësisë, me probleme të shumta dhe të trashëguara, në mes të mandatit u godit me arrestime dhe procedura hetimore e gjyqësore të zyrtarëve më të lartë shtetërorë për çështje që nuk kishin të bënin me mandatin e kësaj ministrie. Situatën e bënte më të ndërlikuar nënfinancimi tejet serioz i shërbimeve shëndetësore në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, përkundër rritjes së vazhdueshme të ndarjeve buxhetore, por jo në masën e duhur.

Në vazhdim tha se që nga fillimi i mandatit të tij si ministër i Shëndetësisë mendon se e vetmja rrugëdalje nga situata aktuale është reformimi i sistemit aktual shëndetësor dhe reformimi i organizimit të brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, krahas vendosjes së shëndetësisë në prioritetet politike të Qeverisë dhe institucioneve të tjera relevante të shtetit.

Jemi në ditët kur të dy këta mekanizma themelorë për tejkalimin e problemeve aktuale janë vendosur. Pas më shumë se dy vjetëve të përpjekjeve, është në fuqi Ligji i shëndetësisë, që do ta ndryshojë sistemin shëndetësor të vendit në mënyrë përmbajtësore, së dyti, në Qeveri u miratua Rregullorja e re për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, e cila do të mundësojë që ta bartë këtë reformë me sukses.

Ai më pas foli për pakon e rregullativës ligjore në fushën e shëndetësisë, duke përmendur Ligjin për kontrollin e duhanit, miratimin në parim të Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë, të Projektligjit për transplantimin e organeve, Projektligji për transplantimin e indeve dhe qelizave dhe Projektligji për produktet midicinale dhe pajisjet mjekësore, ndërsa theksoi se para miratimit në Qeveri është edhe Projektligji për sigurime shëndetësore, me të cilin do të rumbullakohet korniza legjislative, e cila përfundimisht do ta ndajë shëndetësinë kosovare nga aktualiteti i mbijetesës.

Ministri Ferid Agani më tutje u fokusua në disa prej arritjeve kryesore të Ministrisë së Shëndetësisë në periudhën e kaluar dyvjeçare, duke përmendur fillimin e punës në Institutin Onkologjik, përfshirë shërbimet kemoterapeutike dhe radioterapeutike për herë të parë, fillimin e punës në shërbimin e Kardiokirurgjisë, mbulimin me 95% të popullatës me imunizim në

kuadër të programit të zgjeruar të imunizimit, akreditimin në nivel ndërkombëtar, Qendra e laboratorëve testues të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik me ISO standarde dhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë u certifikuan laboratorë të mikrobiologjisë për fruth, rubellë, shyta dhe tuberkulozë, licencimin e prodhuesit të parë farmaceutikë për eksportin e barnave në bazë të certifikatës të prodhimit të mirë, licencimin e prodhuesit të parë vendorë të pajisjeve mjekësore, punësimin e 239 mjekëve dhe stomatologëve, prej të cilëve 145 në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, punësimin e 153 infermierëve, sigurimin e 100 vendeve të reja të punës për Spitalin e Mitrovicës, dhënien e 550 kontratave për specializime, dedikimin për herë të parë të 18 specializimeve për mjekë dhe stomatologë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, dhe një specializim për mjek nga Mali i Zi, prej këtyre 10 me financim nga Ministria e Shëndetësisë, si dhe punësimin e 300 punëtorëve shëndetësorë në sektorin privat të shëndetësisë dhe realizimin e investimeve të huaja e donacione në vlerë prej 15 milionë eurove, vetëm brenda vitit 2012.

Më pas, ai shfaqti zotimin se Ministria e Shëndetësisë është duke punuar me vendosmëri të madhe në eliminimin e mangësive dhe vështirësive në shëndetësinë e Kosovës.

Ministri më tej theksoi se pa dashur të inkuadrohet në debat polimizues me parashtruesit e kërkesës përkitazi me këto çështje, ai do t'u përgjigjet vlerësimeve të parashtruesve të kërkesës në disa çështje konkrete, siç janë: Qeveria e Kosovës e ka mbështetur në plotësi reformën në sektorin e shëndetësisë dhe se konstatimi se Qeveria nuk e ka pasur për qëllim ndryshimin e gjendjes në shëndetësi dhe se nuk bën përpjekje serioze për ta përmirësuar sistemin shëndetësor nuk qëndron, vlerësimin se Ministria e Shëndetësisë nuk është përballur drejtpërdrejt me problemet e shëndetësisë dhe se merret vetëm me letra e quajti të padrejtë. Sa u përket raporteve të Ministrisë së Shëndetësisë me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës dua të theksoj se jemi një prej ministrive që në mënyrë të përpiktë i ka zbatuar vendimet e këtij këshilli, Ligji i shëndetësisë, i cili në nenin 62 i jep të drejtë Ministrisë së Shëndetësisë që asnjë punëtor në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe spitalet rajonale nuk i përket Shërbimit Civil të Administratës Shtetërore, tha ai.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për interpelancën e ministrit Ferid Agani.

Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se shëndetësia në Kosovë ka kohë që vuan nga një sëmundje kronike, së cilës nuk po i kushtohet vëmendje e duhur. Ne mjekët e dimë se në raste të tilla është i vështirë shërimi.

Në vazhdim, ajo theksoi se kërkesa për interpelancë e ka një arsytim të pamjaftueshëm dhe të paargumentuar mirë, krahasuar me titullin “Problemet në shëndetësi” dhe gjuajtja e fajit te Qeveria. Pastaj, shihet një tendencë, thua se Qeveria nuk paska bërë asgjë në këtë sektor dhe mohohet hyrja e reformave në shëndetësi, gjë që nuk është e vërtetë, sepse reformat në shëndetësi tanimë kanë filluar.

Si anëtare e Komisionit për Shëndetësi, e di gatishmërinë e ministrit që t'i përgjigjet çdoherë komisionit dhe temat për të cilat është thirrur interpelanca janë diskutuar disa herë në Komisionin për Shëndetësi. Dhe, ai është thirrur nga vetë anëtarët e komisionit dhe është përgjigjur në këto pyetje, për të cilat sot po diskutojmë, ose për të cilat është thirrur interpelanca.

Më pas, ajo theksoi se Ministria e Shëndetësisë tani më e ka marrë pëlqimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore për rrugëtimin e Projektligjit për sigurimet shëndetësore.

Ne mund të themi se Shëndetësisë i mungon shumëçka dhe e dimë këtë, e mbi të gjitha i mungon kualiteti i shërbimeve. Ka mungesë të etikës shëndetësore, të higjienës në institucionet shëndetësore, nuk respektohen të drejtat e pacientëve, ka mosrespektim të orarit të punës, mungesë të barnave dhe një menaxhim jo i mirë, e jo i sanksionushëm deri më tani, e shkaqet duhet të kërkuar sigurisht dhe ato qëndrojnë jashtë temës, për të cilën po flasim.

Më tutje, ajo u fokusua në një varg strategjish që u hartuan në Ministrinë e Shëndetësisë për një kohë të shkurtër, e këto janë: Strategjia për cilësinë e shërbimeve dhe të drejtave të pacientëve, në proces është revidimi i strategjisë së shëndetësisë sektoriale, është miratuar strategjia e shëndetit të nënës, fëmijëve, adoleshentëve dhe shëndetit reproduktiv, është në fazën e dytë dhe besoj në përfundim zhvillimi i strategjisë së sistemit të informimit në shëndetësi.

Deputetja Flora Brovina vuri në pah edhe fillimin e punës në ofrimin e shërbimeve të reja në një varg institucionesh shëndetësore në Republikën e Kosovës.

Rita Hajzeraj-Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se sa u përket çështjeve dhe mangësive e anomalive në sektorin e shëndetësisë, mendon se të gjitha ato probleme që kanë ekzistuar deri më sot, ekzistojnë përsëri, por vazhdimisht po shkojnë duke u thelluar, dhe ky është shqetësim për Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Sa i përket buxhetit, i cili ndahet për Ministrinë e Shëndetësisë, që është 128,4 milionë, është diku rreth 8,1 e buxhetit në total, prej 1,5 miliard, atëherë konsiderojmë se ky buxhet është jashtëzakonisht i vogël dhe nuk i plotëson as për së afërmi kërkesat e qytetarëve të Kosovës, sa i përket aspektit shëndetësor.

Lidhja Demokratike e Kosovës mendon se problemi kryesor në këtë kohë në institucionet shëndetësore publike është mungesa e barnave, të cilat shumica e pacientëve duhet t'i blejnë vetë.

Në vazhdim, ajo u fokusua në problemet me të cilat ballafaqohet QKUK-ja si institucioni i vetëm që ofron shërbime shëndetësore të nivelit terciar në Kosovë, duke e përmendur mungesën e ilaçeve dhe materialit shpenzues mjekësor elementar për funksionimin e reparteve më vitale, siç janë qendrat emergjente, sallat e operacionit, kujdesi intensiv, sallat e lindjes, e tjera.

Miratimi i Ligjit për shëndetësinë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pa Ligjin për sigurime shëndetësore dhe pa sistemin informativ shëndetësor, e bën këtë ligj të pazbatueshëm në praktikë.

Ajo më tej vlerësoi se qytetarët e Kosovës tani derdhen rreth 60 milionë euro në spitalet e regjioneve për shërbime jashtë vendit, që i bie se të gjitha pajisjet, të cilat ekzistojnë në QKUK, shumica e tyre nuk funksionojnë, apo nuk funksionalizohen.

Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, tha se në këtë legjislacion, energji dhe kohë të madhe ka marrë një temë që ka tërhequr vëmendjen dhe përkushtimin e deputetëve, por edhe të qytetarëve, e që është tema e reformës në shëndetësi.

Lëvizja “Vetëvendosje” pati paralajmëruar se reforma në shëndetësi është shumë e vështirë, pa ndodhur një reformë në tërë sistemin qeverisës në Kosovë. Ta reformosh shëndetësinë në dobi të qytetarit në ambientin e korrupsionit dhe logjikës së profitit, mendja rationale e nxjerr si të pamundur.

Komiteti për Shëndetësi i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka trajtuar idenë e reformës shëndetësore. Me programin qeverisës të Lëvizjes “Vetëvendosje”, reforma i ka katër shtylla, e secila nga to është e domosdoshme për suksesin.

Më pas, ai u fokusua në sqarimet që kanë të bëjnë me këto katër shtylla, veç e veç.

Shfrytëzimi i pozitës në shëndetësinë publike për realizim të profitit me atë private ka qenë dhe mbetet sëmundja kryesore e sistemit shëndetësor.

Sa u përket rekomandimeve, ai theksoi se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do t’i votojë, por mendojmë se janë të pamjaftueshme për ndryshime.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fillimisht i kritikoi arsyetimet që shpeshherë dëgjohen se sfidat i kemi të trashëguara. Për çdo njeri që pak kupton nga qeverisja dhe nga sistemi normal nuk do koment për kaq kohë edhe të thirremi në sfidat e trashëguara dhe të thuhet se nuk po kemi çfarë të bëjmë.

Në një vend me 2 milionë banorë për dy vjet të paktën disa prej sfidave të trashëguara është dashur të tejkalohen. Në vazhdim, ai shtroi pyetjen se nëse një pacient shkon në Qendrën Klinike Universitare a e gjen më mirë sot se para dy vjetëve.

Në fund, deputeti **Ardian Gjini** tha të shpresojmë se për pjesën e mandatit të mbetur, ministri do të ndërmarrë veprime më efikase në funksion të përmirësimit të kushteve, duke u nisur nga Qendra Klinike Universitare dhe për të vazhduar më tutje.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se i mbështetim reformat e ndërmarra në sistemin shëndetësor dhe shpresojmë shumë shpejt që në këtë Kuvend do të procedohet Projektligji për sigurimet shëndetësore.

Në vazhdim, ajo u fokusua në çështjen e zbatimit të Ligjit për sigurimet shëndetësore, pas miratimit të tij në Kuvend.

Diskutimet e deputetëve: **Time Kadrijaj, ministrit Ferid Agani, Flora Brovina, Rita Hajzeraj-Beqaj, Liburn Aliu, Ardian Gjini dhe Myzejene Selmani**, janë dhënë të plota në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: **Aurora Bakalli, ministri Ferid Agani, Berat Buzhala, Haki Demolli, Albulena Haxhiu, Teuta Haxhiu, Hykmete Bajrami, Halit Krasniqi, Lutfi Haziri, Alma Lama, Salihe Mustafa, Sali Asllanaj, Visar Ymeri, Kymete Bajraktari, Blerta Deliu-Kodra, Shaip Muja, Bekim Haxhiu, Elmi Reçica dhe Sadri Ferati**, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Deputeti Ramiz Lladrovci tha se diskutimin e tij do ta dorëzojë me shkrim.

Në fund të diskutimeve, ministri Ferid Agani dha shpjegime lidhur me rekomandimet e propozuara nga deputetja Time Kadrijaj dhe grupi i deputetëve nënshkrues, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Në fund, në emër të propozuesit të interpelancës, deputetja Time Kadrijaj i paraqiti rekomandimet e propozuara.

Kryesuesi më pas i hodhi në votim rekomandimet e propozuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 31,
Kundër ----- 18,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nxori këto:

R E K O M A N D I M E

1. Të zbatohen vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për konkursin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, por edhe për zyrtarët e lartë në Ministrinë e Shëndetësisë që janë edhe specialistë.
2. Projektligji i sigurimeve shëndetësore të dërgohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës në Kuvendin e Republikës së Kosovës sa më shpejt për miratim.
3. Të respektohet Ligji i menaxhimit të financave publike, sidomos procedurat e tenderimit.
4. Të raportohet në seancat e rregullta për gjendjen në sistemin e informimit shëndetësor, agjencinë e financimit, planifikimin e kuadrove, sistemin shëndetësor primar, sekondar dhe terciar, si dhe Agjencinë e Produkteve Medicinale dhe Barnave.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për administrimin e punës në zyrë

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për administrimin e punës në zyrë.

Deputeti Idriz Vehapi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se për këtë projektligj nuk janë paraqitur amendamente.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për administrimin e punës në zyrë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për administrimin e punës në zyrë.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për provimin e jurisprudencës.

Kryesuesi i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9,10, 11 dhe 12.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 52,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për provimin e jurisprudencës.

8. Zgjedhja e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për paraqitjen dhe arsyetimin e raportit me rekomandime.

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, tha se si komision e kemi shqyrtuar propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe kemi rekomanduar miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryesuesi e hodhi në votim miratimin propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----37,
Kundër ----- 18,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Adem Vokshi emërohet anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore.
2. Mandati i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore është një (1) vit.

* * *

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 14: 57 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale